



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 37 (827735)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 10 Shtator 2021

Gjeneralmajor Bajram Begaj në ceremoninë për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale (FOC), të Komandës së JSEC



Gatishmëri, bashkëveprim dhe koordinim

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në ceremoninë për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale, të Komandës së Bashkuar të NATO-s për Mbështetjen (JSEC – Joint Support and Enabling Command), të zhvilluar në Ulm, Gjermani. Në ceremoninë e

organizuar me këtë rast morën pjesë përfaqësues të niveleve më të larta të komandave strategjike të NATO-s, ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, komandanti suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), drejtori përgjithshëm i Stafit Ushtarak Ndërkombëtar (DGIMS), kryetari i Bashkisë së Ulm, si dhe... >>> faqe 4

Aleksandër Peci: Nder dhe privilegj të shërbeja në Afganistan për Shqipërinë, vend anëtar i NATO-s
Intervistë me ushtarakun shqiptar që u plagos nga talebanët gjatë misionit, ku mbeti i vrarë kapiteni Feti Vogli



>>> faqe 6

Menaxhimi i zjarreve

Rama dhe Peleshi vlerësojnë punën e forcave të angazhuara dhe Mbrojtjes Civile

Në 389 vatra të zjarrit u angazhuan 4960 trupa dhe 152 mjete të FA, 3309 trupa dhe 113 mjete zjarrefikëse. 1914 forca lokale të të gjitha bashkive, 1400 forca vullnetare, 489 forca të Policisë së Shtetit, 606 forcat e Shërbimit Pyjor dhe e gjithë administrata e Mbrojtjes Civile >>> faqe 3



Takimi

Ministri Peleshi: Të gjitha vendet e NATO të marrin përgjegjësitë për ngjarjet në Afganistan

Shqipëria mbetet një aleate e denjë e NATO-s dhe partnerëve strategjikë. Ky vullnet është theksuar nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në 7 gusht 2021, gjatë bisedës, me ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Letonisë Artis Pabriks, i cili ishte në Tiranë, për një vizitë zyrtare. Ministri i Mbrojtjes Peleshi vuri në dukje faktin se Shqipëria iu përgjigj menjëherë thirrjes së NATO-s dhe kontribuoi me trupa në kuadër të...



>>> faqe 2

Bashkëpunimi

Rishikimi i Doktrinës për Trupën e Nënoficerëve në FA

Në kuadër të bashkëpunimit me ekipin e nënoficerëve të lartë të Gardës Kombëtare të New Jersey (GKNJ) në mjediset e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të Akademisë së Forcave të Armatosura, nga data 30 gusht deri me datë 03 shtator, u zhvillua aktiviteti "Rishikimi i Doktrinës për Trupën e Nënoficerëve në FA". Ekipi u prit edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj...

>>> faqe 4



Qëllimi i NATO -s është një botë pa armë bërthamore

MSC. MIMOZA GOLIKJA

>>> faqe 10

SISTEM I INTEGRUAR

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, strukturë e rëndësishme e Ministrisë së Mbrojtjes >>> faqe 5

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Akademiti Ushtarake të Turqisë kërkojnë 5 kandidatë për studime >>> faqe 8

Shqipëria mbetet një aleate e denjë e NATO-s dhe partnerëve strategjikë. Ky vullnet është theksuar nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në 7 shtator 2021, gjatë bisedës, me ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Letonisë Artis Pabriks, i cili ishte në Tiranë, për një vizitë zyrtare.

Ministri i Mbrojtjes Peleshi vuri në dukje faktin se Shqipëria iu përgjigj menjëherë thirrjes së NATO-s dhe kontribuoi me trupa në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (eFP) të NATO-s, në kufirin e saj lindor që prej vitit 2017, ndërsa kontingjenti shqiptar EOD mbetet i angazhuar krahas me forcat e Aleancës, si pjesë e grupbatalionit shumëkombësh, të drejtuar nga Kanadaja. Ministri Peleshi përmendi incidentin tragjik që ndodhi në “Kamp Adazi”, ku humbën jetën dy ushtarakët tanë, major Klodian Tanushi dhe nëntetar Zarife Hasanaj, ngjarje e cila forcoi edhe më shumë lidhjen midis dy vendeve.

Gjatë bisedës me homologun letonez, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi foli edhe për ngjarjet në Afganistan, ku Shqipëria vendosi të dalë në krahasim të SHBA-së.

“Vendi ynë mbështeti vendimin e NATO-s për të tërhequr trupat nga Afganistani. Sidoqoftë, duke pasur parasysh zhvillimin e fundit, ne nuk mund të bënim më shumë sesa të riafirmim angazhimin tonë. Shqipëria është e gatshme dhe nuk ka asnjë hezitim për të përballuar pjesën e saj të barrës. Një peshë që, për mendimin tonë, duhet të mbahet gjithashtu nga vendet e tjera të Aleancës. Deri më këto ditë kanë gjetur strehim në vendin tonë mbi 600 qytetarë afganë dhe kemi shprehur qartë vullnet të plotë dhe gatishmërinë për të pritur edhe të tjerë në nevojë”.

Më tej, ministri Peleshi u shpreh se sfidat tona të sigurisë mbeten të përbashkëta, të pandashme dhe të gjithanshme. Ato vijnë nga çdo drejtim dhe mund të cenojnë sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë dhe më gjerë.

Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë vlerëson dislokimin e Forcave të Armatosura letoneze në misionin e KFOR-it, në Kosovë, si një kontribut të madh për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Sipas ministrit Peleshi, mbështetja e Kosovës në aspiratat e saj kundrejt anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e paqes dhe sigurisë, inkurajon zhvillimin e rajonit dhe frenon zgjerimin e influencës të vendeve të tjera që sfidojnë demokracinë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

“Vizita e Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Letonisë, z. Artis Pabriks – Të angazhuar për të thelluar bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në arsimimin ushtarak dhe forcimin e marrëdhënieve midis Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Kolegjit Baltik të Mbrojtjes. Shqipëria është e vendosur gjithashtu të vazhdojë kontributin në “Kamp Adazi” të Letonisë, në kuadër të prezencës së NATO-s atje.”, shkroi ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në rrjetin social.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi pret homologun letonez:

Të gjitha vendet e NATO-s të marrin përgjegjësitë për ngjarjet në Afganistan



Nis regjistrimi në Akademinë e Forcave të Armatosura

Procesi i regjistrimit është i ndarë në 7 faza 48-orëshe

Vëmendjet!

- Më ngjritë jehilla. Duhet të regjistroheni brenda fazës së parë, nëse nuk keni bërë kështu, do të keni vlerë të ulët në listën e kandidatëve të pranueshëm.
- Konfirmimi për suksionin e programit ka një regjistrim në deklarimin që ju firmosni në aplikim.
- Më ngjritë në vendit. Sapo jeni shpallur fitues në aplikim, por duhet të përfundoni e fazën për t'u regjistruar.
- Më të kujto. Nuk jeni fitues. Kontrolloni shtetërisht "Dokumentet në fazën e ardhshme".

Në Akademinë e Forcave të Armatosura, më 2 shtator 2021, filloi regjistrimi i maturantëve që janë pjesë e listës së fituesve të raundit të parë, për të ndjekur studimet Bachelor në fushën e “Shkencës Ushtarake”, “Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes” dhe “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”. Regjistrimet për fituesit e raundit të parë fillojnë nga data 2 shtator deri më 15 shtator. Procesi i regjistrimit është i ndarë në 7 faza 48-orëshe.



Menaxhimi i zjarreve

Rama dhe Peleshi vlerësojnë punën e forcave të angazhuara dhe Mbrojtjes Civile

Në 389 vatra të zjarrit u angazhuan 4960 trupa dhe 152 mjete të FA, 3309 trupa dhe 113 mjete zjarrfikëse. 1914 forca lokale të të gjitha bashkive, 1400 forca vullnetare, 489 forca të Policisë së Shtetit, 606 forcat e Shërbimit Pyjor dhe e gjithë administrata e Mbrojtjes Civile

Nga Baza Ajrore e Farkës, kryeministri Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shprehën mirënjohjen për të gjithë efektivët e Forcave të Armatosura, forcat zjarrfikëse, policore e bashkiake, por edhe ata vullnetarë, forca të shërbimit pyjor e të zonave të mbrojtura që u angazhuan për shuarjen e zjarreve në të gjithë territorin e vendit, gjatë muajit gusht.

Në aktivitetin e zhvilluar në 3 shtator 2021, ku morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako, ambasadori i Bashkimit Evropian Luigi Soreca si dhe zëvendësambasadori i SHBA Demian Smith, kryeministri Rama falënderoi SHBA dhe partnerët e BE, Holandën dhe Çekinë që përmes Mekanizmit të Mbrojtjes Civile kontribuan në normalizimin e situatës.

Kryeministri Rama vuri theksin tek rëndësia që ka vijimi i procesit të modernizimit të Mbrojtjes Civile, i cili tashmë ka dhënë rezultatet e para të prekshme. Po ashtu kryeministri garantoj se qeveria do të bëjë atë që duhet për të rritur pagën për trupat që përballen me sfida që kërcënojnë jetën. Kreu i qeverisë theksoi se për zjarrvënësit duhet të jepen dënimet maksimale.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi teksa shprehu ngushëllimet për dy qytetarët që humbën jetën si pasojë e zjarreve tha se “për shuarjen e flakëve u angazhuan 4960 trupa dhe 152 mjete të FA, 3309 trupa dhe 113 mjete zjarrfikëse. 1914 forca lokale të të gjitha bashkive, 1400 forca vullnetare, 489 forca të Policisë së Shtetit, 606 forcat e Shërbimit Pyjor dhe e gjithë administrata e Mbrojtjes Civile. Kjo



ishte fuqia njerëzore dhe motorike e operacioneve nga toka për të luftuar me 389 vatra të zjarrit në të gjithë vendit në harkun e dy muajve.

Ndërkohë për ndihmën nga ajri, iu bashkuan forcës së tre mjete helikopterë nga Holanda, 2 mjete nga Çekia”. Ministri i Mbrojtjes evidentoi

mbështetjen e vyer të ofruar nga SHBA, me ekspertët që asistuan dhe e bënë më efektiv operacionin.

Ministri i Mbrojtjes tha se ndërhyrja në kohë dhe heroike e forcave tona shmangu më të keqen, ndërsa njoftoi se pak ditë më parë është realizuar për herë të parë një kontratë model për mirëm-



bajtjen e helikopterëve. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj tha se Forcat e Armatosura janë përballur në një luftë të ashpër me zjarret për 3 javë, por ia kanë dalë që të minimizojnë dëmet dhe të shpëtojnë jetë njerëzish.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë

Kombëtare të Emergjencës Civile Haki Çako deklaroi si rezultat e vatrave masive që përfshinë vendin gjatë periudhës korrik-gusht u dëmtuan 33,420 hektarë kullota, pyje e shkurre si dhe mbi 14.234 mijë rrënjë ullinj e pemëtari. Ndërsa në të gjithë vendin shpërthyen 389 vatra zjarri

“Medalja e Artë për Vlerësim Profesional” dhe “Medalja e Mirënjohjes”

Forca Tokësore dekorohet për kontributin e dhënë në menaxhimin e emergjencave në shuarjen e zjarreve

Pas një muaji sfidues të përballjes me zjarret që përfshinë vendin, më 03 shtator 2021 në Bazën Ajrore të Farkës u zhvillua ceremonia e vlerësimit të strukturave dhe individëve që u angazhuan në operacionet për shuarjen e zjarreve në vend. Pjesë e kësaj ceremonie ishte kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, ambasadori i Bashkimit Evropian Luigi Soreca, zëvendësambasadori i SHBA, si dhe zyrtarë të lartë të ftuar në vend.

Kjo ceremoni u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha strukturave që kontribuan për shuarjen e zjarreve në vend, Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile etj.

Forca Tokësore u dekorua me “Medaljen e Artë për Vlerësim Profesional” nga kryeministri i Republikës së Shqipërisë, si dhe me “Medaljen e Mirënjohjes” nga ministri i Mbrojtjes, për kontributin e dhënë në shuarjen e zjarreve.

Gjithashtu, u nderuan me medalje komandantët e dy strukturave vartëse të FT, nënkolonel Gëzim Marku, komandant i Batalionit III të Këmbëorisë dhe major Pëllumb Hidri zëvendëskomandant i Batalionit Komando.



Në fjalën e tij, kryeministri Edi Rama ndër të tjera theksoi: “Medalje e artë për Forcën Tokësore dhe dua t’u them të gjithë trupave, është mesazh për të gjithë trupat e Emergjencave Civile, se

do të bëjmë të pamundur për për të rritur pagat, që nuk do të jetë asnjëherë e mjaftueshme, sidoqoftë është një motiv më shumë jo vetëm për të çuar në shtëpi të ardhura të merituar nga puna, por edhe për të ndërjerë



vlerësimin dhe respektin për vendin dhe atdheun”.

Në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes kërkoi sa më shumë reflektim nga organet vendore në përballimin e kësaj situatë. Ai u shpreh se duhet

modernizim i legjisllacionit, planifikim logjistik, ngritje të kapaciteteve të reja për përballimin e çdo emergjence.

Ceremonia u përfundua me vendosjen e medaljes së artë në Flamurin Luftarak të Forcës Tokësore.

BASHKËPUNIMI

Rishikimi i Doktrinës për Trupën e Nënoficerëve në FA

Nënoficerë të lartë të Gardës Kombëtare të New Jersey zhvillojnë vizitë pune në Shqipëri

Në kuadër të bashkëpunimit me ekipin e nënoficerëve të lartë të Gardës Kombëtare të New Jersey (GKNJ) në mjediset e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të Akademisë së Forcave të Armatosura, nga data 30 gusht deri me datë 03 shtator, u zhvillua aktiviteti "Rishikimi i Doktrinës për Trupën e Nënoficerëve në FA". Ekipi u prit edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, i cili theksoi se në vizionin e tij trupa e nënoficerëve duhet të marrë më shumë përgjegjësi dhe ky dokument është një hap i rëndësishëm në implementimin e këtij vizioni. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj falënderoi ekipin për kontributin dhe asistencën e tyre duke ju shprehur mbështetjen e tij në projektet dhe iniciativat për ngritjen profesionale të trupës së nënoficerëve të FARSH.

Aktiviteti u drejtua nga nënoficeri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, ku morën pjesë ekipi i nënoficerëve të GKNJ dhe nënoficerët të lartë të strukturave kryesore të FARSH. Fokusi

kryesor i këtij aktiviteti ishte prezantimi i dokumentit "Udhëzues mbi rolin, detyrat dhe autoritetin për nënoficerët e FARSH", të përgatitur nga grupi i punës së GKNJ. Gjithashtu midis ekipeve të GKNJ dhe FARSH pati diskutime mbi thellimin e bashkëpunimit dhe të asistencës në përgatitjen dhe zhvillimin e trupës së nënoficerëve të FA. Gjithashtu, ekipi ndoqi nga afër edhe punën që është duke u bërë nga komandat kryesore, siç është ajo e Forcës Tokësore, ku komandanti i saj gjeneral brigade Arben Kingji ka ngritur një grup pune për vlerësimin dhe implementimin e doktrinave për trupën e nënoficerëve. Përgatitja e dokumentit "Udhëzues mbi rolin, detyrat dhe autoritetin për nënoficerët e FARSH" ka filluar që në muajin maj 2021. Ky dokument do të shërbejë si dokument themelor për hartimin e rregulloreve, politikave dhe udhëzimeve për arsimimin, stërvitjen dhe zhvillimin e karrierës dhe është në sinkron me Strategjinë e NATO-s për Nënoficerët, shtator 2017.



Gatishmëri, bashkëveprim dhe koordinim

Gjeneralmajor Bajram Begaj në ceremoninë për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale (FOC), të Komandës së JSEC

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në ceremoninë për arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale, të Komandës së Bashkuar të NATO-s për Mbështetjen (JSEC - Joint Support and Enabling Command), të zhvilluar në Ulm, Gjermani.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë përfaqësues të niveleve më të larta të komandave strategjike të NATO-s, ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, komandanti suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), drejtori përgjithshëm i Stafit Ushtarak Ndërkombëtar (DG-IMS), kryetari i Bashkisë së Ulm, si dhe shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të vendeve të Aleancës.

Komandanti i JSEC, gjenerallejtënant Jürgen Knappe, nëpërmjet kësaj ceremonie synoi promovimin e kësaj strukture të re të NATO-s, rolin e rëndësishëm që ajo do të marrë në operacionet e Aleancës për sigurimin e mbështetjes dhe përfundimin e forcave. Njëkohësisht, aktiviteti synonte edhe vendosjen e komunikimit me vendet e Aleancës si dhe ato partnere për integrimin e mëtejshëm të përpjekjeve dhe aktiviteteve në funksion të operacioneve të Aleancës.

Gjatë këtij aktiviteti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj shprehu gatishmërinë se bashkëveprimi dhe koordinimi në të ardhmen me Komandën e JSEC do të jetë shumë i ngushtë, kjo pasi çdo dislokim i kontributeve të FARSH jashtë territorit të vendit si dhe forcave të NATO-s brenda zonës së përgjegjësisë së SACEUR do të koordinohet nga kjo strukturë.

JSEC është një strukturë e re brenda NATO-s dhe ka një rol të rëndësishëm për sigurimin e dislokimit, lëvizjes së trupave dhe mbështetjes së operacioneve. Gjermania është vend lider në këtë strukturë, në të cilën marrin pjesë personel nga 22 vende të NATO-s, ndërkohë që Shqipëria kontribuon me një oficer në drejtorinë e planifikimit.



Efektivë të Forcës Tokësore trajnohen për përdorimin e UAV-ve nga specialistët e Gardës Kombëtare të New Jersey-it

Në kuadër të bashkëpunimit Ushtarak me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, SHBA, në datat 29 gusht 2021 deri më 03 shtator, në mjediset e Forcës Tokësore u zhvillua një trajnim mbi njohjen dhe përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot (UAV). Efektivë nga Batalioni i Dytë i Këmbësorisë dhe Kompanisë së Zbulimit, pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale, për më se një javë u trajnuan nga ekspertët amerikanë me qëllim njohjen, familjarizimin dhe përdorimin e UAV-ve, të cilat i janë shtuar së fundmi kapaciteteve të Forcës Tokësore.

Ekipi i ekspertëve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it i përbërë nga katër ushtarakë, mes tyre edhe togerja me origjinë shqiptare Hatixhe Çollaku, kanë trajnuar efektivët e Forcës Tokësore, të cilët do të jenë përdoruesit e ardhshëm të këtyre mjeteve moderne. Ekspertët amerikanë kanë mundësuar njohjen me këto pajisje, si dhe me natyrën e operacioneve ushtarake që mund të përdoren për mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të nevojshme.

Ekspertët amerikanë janë pritur në një takim të veçantë nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili ka vlerësuar maksimalisht ndihmën dhe mbështetjen e SHBA-së në drejtim të zhvillimit dhe modernizimit të Forcës Tokësore. Gjeneral brigade Kingji shprehu rëndësinë e mjeteve të reja të dhuruara së fundmi nga SHBA, të cilat do të rrisin ndjeshëm kapacitetet operacionale të njëjsteve prioritare të Forcës Tokësore.



GARDA KOMBËTARE E NEW JERSEY-IT

Aktivitete trajnuese në fushën e Trajnimit dhe të Doktrinës së trupës së nënoficerëve

Akademia e Forcave të Armatosura dhe Komanda e Forcës Tokësore kanë mirëpritur këto ditë një ekip ushtarakësh të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, SHBA. Në datat 29 gusht 2021 deri më 04 shtator, 13 nënoficerët me gradën më të lartë në FARSH janë njohur me ekspertizën amerikane në drejtim të politikave të zhvillimit të nënoficerëve të rinj, si dhe mbi evoluimin e bazës doktrinare të zhvillimit të nënoficerëve në Forcat e Armatosura.

Ekipi i ekspertëve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, i



përbërë nga katër ushtarakë, nëpërmjet një programi intensiv, kanë njohur pjesëmarrësit në këtë aktivitet me element të rëndësishëm të programeve të zhvillimit të trupës së nënoficerit, si elementi bazë i përgatitjes së trupës në Forcat e Armatosura. Për më se një javë, nënoficerët shqiptarë kanë shkëmbyer mendime dhe ekspertizë me kolegët amerikanë në drejtim të rolit të nënoficerit, edukimit dhe zhvillimit të tyre, si dhe mbi detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Aktiviteti i përbashkët pati në fokus prezantimin e dokumentit të përgatitur nga grupi i ekspertëve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it në lidhje me operacionet e përbashkëta ndërkombëtare, rolin e nënoficerit në këto operacione, si dhe mbi mundësinë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejshëm për zhvillimin e trupës së nënoficerëve të FARSH-it.

Sistem i integruar dhe efikas i mbrojtjes civile

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), strukturë e rëndësishme e Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja Civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t'u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është person juridik publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

AKMC ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

AKMC organizohet si drejtori e përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas qendrave të mbrojtjes civile në qark. Brenda strukturës së AKMC funksionon Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, e cila harton programe, strategji dhe dokumente e metodologji për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel kombëtar; Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, e cila realizon gatishmërinë dhe koordinimin e strukturave të mbrojtjes civile për menaxhimin e informacionit mbi një kërcënim të afërt apo rrezik të evidentuar dhe vendosjen në veprim të kapaciteteve të nevojshme që disponohen, për përgjigjen e menjëhershme dhe përballimin e situatës së emergjencës civile apo ndihmës humanitare; Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, e cila monitoron realizimin e masave strukturore për shmangien apo zvogëlimin e ndikimit të rreziqeve, masave për rehabilitimin e rimëkëmbjes dhe komunitetit/shoqërisë të prekur nga një fatkeqësi, si dhe krijimin e bazës së të dhënave kombëtare të humbjeve nga fatkeqësitë, vlerësimin e tyre dhe kompensimin; Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve, e cila bashkërendon veprimtarinë ndër-institucionale për bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë e të projekteve në fushën e mbrojtjes civile, si dhe programimin dhe zbatimin e mbështetjes financiare nga donatorë dhe organizma të huaj apo vendas; Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit, e cila harton dhe zhvillon programet e edukimit e trajnimit e komunitetit dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile për rritjen e aftësive të parandalimit dhe përgjigjes ndaj situatave të emergjencës civile apo fatkeqësive, si edhe zbatimin dhe miradministrimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit; Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, e cila siguron miradministrimin e burimeve financiare, njerëzore, asetëve e shërbimeve, si dhe ofrimin e këshillimit ligjor dhe plotësimin e nevojave për mallra e shërbime të aparatit të institucionit, Qendrat e Mbrojtjes Civile në Qarqet: Shkodër, Durrës, Fier dhe Korçë, të cilat përgjigjen për



monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes civile nga institucionet publike në nivel vendor/rajonar, dhe koordinimin e bashkëpunimit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe kryerjen e operacioneve të emergjencave civile.

Funksionet dhe roli i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Qëllimi i Mbrojtjes Civile është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimi i mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të Mbrojtjes Civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimit dhe inspektimin. Për shkak të karakteristikave gjeografike të Shqipërisë, fatkeqësitë natyrore, sidomos përmbytjet, zjarret, tërmetet, rrëshqitjet e tokës, si dhe bllokimet nga reshjet e borës, janë dukuri të zakonshme. Rreziku i fatkeqësive mjedisore është në rritje, për shkak të urbanizimit dhe industrializimit, megjithatë, nuk përjashtohen dhe kërcënimet bashkëkohore të terrorizmit dhe të epidemive të ndryshme.

Detyrat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile; Zbaton drejtimet strategjike dhe objektivat e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile; Koordinon dhe bashkërendon punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Planit Kombëtar për

Emergjencat Civile dhe vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror; Bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat homologe ndërkombëtare në kuadër të mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë; Planifikon fonde për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile, kriteret dhe procedurat e akordimit të të cilave përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave; Krijon dhe zbaton metodologjinë për hartimin e planeve për emergjencat civile; Promovon format, metodologjitë, mënyrat racionale për grumbullimin, regjistrimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi fatkeqësitë; Kryen trajnimet

e strukturave shtetërore, të subjekteve private e vullnetare nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për Mbrojtjen Civile; Përgatit programin e trajnimit të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor; Lidh marrëveshje me organizata jofitimprurëse ose subjekte të tjera juridike, brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me mbrojtjen civile; Kryen inspektimin për zbatimin e dispozitave të këtij ligji për mbrojtjen civile për institucionet dhe strukturat shtetërore dhe subjektet private.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) është dokumenti krye-

sor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e Emergjencave Civile. Dokumenti reflekton përvojën për një sërë dukurish të mundshme rreziku, kapacitetet dhe vështirësitë në përballimin e emergjencave civile në Shqipëri; përmbledh informacione, në të cilin janë përshkruar faktorët më të rëndësishëm dhe rolet e të gjitha institucioneve dhe të strukturave të përfshira në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile. Duke mbledhur së bashku dhe duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve, strukturave shtetërore dhe shoqërisë civile, nëpërmjet PKEC synohet:

Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile. Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile. Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave. Në planin afatgjatë, qëllimi kryesor është ai i parandalimit e lehtësimit dhe PKEC-ja është rruga e nevojshme për t'u ndjekur në arritjen e këtij qëllimi.

Ambasadori i Republikës së Turqisë i akredituar në vendin tonë H.E.Murat Ahmet Yörük viziton Forcën Tokësore

Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, Ambasadori i Republikës së Turqisë i akredituar në vendin tonë H.E.Murat Ahmet YÖRÜK me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë, vizitoi ditën e sotme Regjimentin e Operacioneve Speciale në Forcën Tokësore. Qëllimi i kësaj vizite është diskutimi në lidhje me kontributin e Forcave të Armatosura Turke në Regjimentin e Operacioneve Speciale, si dhe fushat e mundshme të bashkëpunimit ushtarak midis Forcës Tokësore dhe Forcave të Armatosura Turke në të ardhmen. Në përfundim të aktivitetit Ambasadori i Republikës së Turqisë H.E.Murat Ahmet YÖRÜK falënderoi gjeneral Kingjin për mikpritjen, vlerësoi



angazhimin dhe kontributin e Forcave të Armatosura shqiptare në kuadër të operacioneve të paqes, si dhe theksoi se bashkëpunimi ushtarak midis Forcës

Tokësore dhe Forcave të Armatosura Turke do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Vizita u mbyll me një foto të përbashkët.

Afganistani, sakrificë që ia vlejti, për 20 vite atje janë bërë shumë ndryshime

Aleksandër Peci: Nder dhe privilegj të shërbeja në Afganistan për Shqipërinë, vend anëtar i NATO-s

Intervistë me ushtarakun shqiptar që u plagos nga talebanët gjatë misionit, ku mbeti i vrarë kapiteni Feti Vogli

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë nisur përgatitjet e përkujtimit të 20 vjetorit të sulmeve të Al-Qaeda mbi kullat binjake në New York, që është edhe pikënisja e misioneve ushtarake të NATO-s në Afganistan, ku u vranë 6.000 ushtarë amerikanë.

Edhe Shqipëria pati një humbje jete, atë të kapitenit Feti Voglit. Për këtë vrasje ndodhur në një provincë të Afganistanit më 20 shkurt 2012, flet për herë të parë në një intervistë televizive i mbijetuari sulmit, ish ushtaraku Aleksandër Peci, i cili tashmë jeton dhe punon në SHBA.

Si e kujtoni pjesëmarrjen tuaj në misionet me trupa ushtarake shqiptare në Afganistan?

Unë kam marrë pjesë në dy misione në Afganistan. Në 2012 me Eagle 4 dhe në 2014 me Eagle 8, që ishte misioni i fundit i forcave special atje. Në 2012 ishte edhe rasti fatal i humbjes së komandantit Feti Vogli. Për mua ka qenë nder dhe jam shumë i privilegjuar që kam shërbyer në Afganistan për Shqipërinë, për një vend të vogël të NATO-s. Ndjem krenar dhe dua të falënderoj të gjithë ata djem pjesëmarrës në misionet paqeruajtëse.

Gjatë kohës kur ishit me trupat speciale, që njihen si "Beretat Vishnje" çfarë detyrash keni përmbushur?

Kemi pasur detyra të ndryshme si për shembull patrullime, kontrole në akse rrugore të ndryshme të Afganistanit, patrullime në qytet si dhe në pikën doganore Afganistan-Pakistan. Kemi shërbyer po ashtu në një komisariat policie që ishte rreth 1 kilometër larg kësaj dogane.

Mund të na e tregoni momentin kur ju u plagosët dhe kapiteni Feti Vogli humbi jetën në Afganistan?

Ka qenë data 20 Shkurt dhe atë ditë ishte inaugurimi i një shkolle që kishte shumë vite e mbyllur. Ne na u ngarkua sigurimi një zonje e cila kishte ardhur nga Amerika për të parë investimet e kësaj shkolle si dhe të spitaleve dhe qendrave shëndetësore. Përpara se të shkonim në atë shkollë kemi hapur edhe një qendër shëndetësore. Më pas shkuam tek shkolla. Ishim një grup i batalionit special i përbërë nga 12 vetë dhe ne kishim detyrë kryesore sigurinë fizike të zonjës. Jashtë kemi qenë unë, komandant Feti dhe kolegu amerikan Michael Trost si dhe një tjetër koleg shqiptar Ylber Dajlani. Ne po merreshim me sigurimin e pjesës së përparme të shkollës. Pas nesh ishte makina e policisë ku ndodhej një polic afgan i cili na goditi nga pas. Nuk e prisim një gjë të tillë të na ndodhte nga policia. Nuk kishte ndodhur më parë. Jemi gjendur nën breshëri. Në momentet kur kemi marrë plumbat e parë ramë në tokë. Kam parë komandant Fetin



rëndë në të djathtë në tokë dhe plumbat e kishin marrë në venat kryesore të qafës nga ku po i dilte shumë gjak. Në krahun tjetër ishte amerikani Michael Trost që kishte marrë një plumb në dorë dhe kishte humbur dy gishtërinj sikurse kishte marrë plumba edhe në këmbë e nisi të bërtiste. Atë moment kam vajtur tek komandanti i ndjerë Feti, duke u munduar ti jap sadopak ndihmë. Kam pyetur kolegun amerikan si ndjehej. Atë moment më doli gjak se kisha marrë një plumb në fytyrë. Nisi dalja e gjakut nga goja. Nën antiplumb kisha një paketë të ndihmës së shpejtë nga ku nxora fashon për t'i dhënë vetes ndihmën e parë e për të ndaluar sadopak gjakderdhjen në qafë. Atë moment kanë dalë edhe pjesëtar të tjerë të grupit duke neutralizuar dhe kapën policin. Nuk mund t'i qëllosh pasi është dorëzuar. Është ligji i luftës dhe nuk mund ta vrasësh. Na erdhën në ndihmë djemtë e repartit tonë dhe asistentët të tjerë për të na mbajtur sadopak. Kemi qëndruar atje 25-30 minuta deri sa erdhi helikopteri për të na marrë mua, Michael dhe komandant Fetin. Gjatë të gjithë kohës ekipi mjekësor i helikopterit po mendohej përmes goditjeve elektro-shock të mbante në jetë komandant Feti Voglin por ishte i pamundur shpëtimi i tij deri në spital. Ka qenë një ditë e vështirë shumë e errët për ne, se ishte humbja e parë pasi ishte komandanti i grupit. Një prej djemve më të përgatitur që ka pasur reparti jonë. Një djalë dhe familjar shumë i mirë. Por lufta i ka këto dhe ne nuk kemi çfarë të bëjmë. Duhet të përballemi me gjithçka.



Nga analiza që ju bëtë më pas, a mund të shmangej ky incident?

Nga analiza e bërë më pas edhe mund të ishte shmangur por ajo ishte një pritë ose pabesi e një Talebani të infiltruar nën uniformën e policisë afgane dhe më vonë në misionet e tjera nuk kemi pasur asnjë rast tjetër, se pa pësuar nuk e mendon. Në misionet e tjera është rritur vigjilenca ndaj policisë e ushtarëve afganë. Nuk kishte më as besë dhe as burrn, siç i thonë, me ta.

Këto 20 vite është derdhur shumë gjak në Afganistan madje edhe gjaku shqiptar i komandant Feti Voglit. Pyetja që të gjithë bëjnë sot që SHBA dhe NATO u larguan nga atje është: A ia vlejti e gjithë kjo sakrificë?

E gjithë kjo sakrificë ia vlejti sepse në Afganistan për 20 vite janë bërë shumë ndryshime. Janë hapur shumë shkolla, duke ulur nivelin e njerëzve të paarsimuar. Janë hapur shumë spitale gjithashtu. Më e rëndësishmja është hapja e shumë shkollave, pasi vajzat nuk lejoheshin të arsimoheshin. I shikoje të lira të lëviznin e të punonin. 20 vite janë shumë, nga ku humbën jetën shumë njerëz mes tyre ushtarakë.

A mendoni se NATO e përmbushi misionin në Afganistan dhe kishte ardhur momenti i duhur për t'u tërhequr?

NATO e ka përmbushur misionin për 20 vite duke angazhuar shumë trupa. Është bërë shumë punë e shumë investime në polici dhe ushtrinë e Afganistanit.

Kishte ardhur koha që qeveritarët afganë, ushtarakët ta drejtonin vetë atdheun e tyre. Ta drejtonin vetë sigurinë sepse nuk mund të presësh gjithë jetën të kesh të sigurt vendin nga NATO, SHBA apo askush tjetër.

Si shpjegohet që një trupë kaq e madhe ushtarake afganase të shpërbëhej, shkërmoqej brenda 24 orëve duke bërë që Talebanët të marshonin si fitimtarë drejt Kabulit?

Është për të ardhur keq se si ky investim kolosal, që është bërë në ushtri apo forcat speciale të Afganistanit si dhe në polici, të shpartallohej. Mbase edhe nga fakti që kishte shumë të infiltruar nga Talebanët dhe kanë pasur frikë. Edhe familjet e tyre kanë qenë të kërcënuara gjatë kohës kur koalicioni ishte atje përpara se të tërhiqeshin. Familjet e tyre në mënyrë konstante ishin të sulmuara nga terroristët.

Për SHBA-në, Afganistani konsiderohej si një vatër terrorizmi e Al-Qaeda. Nga eksperiencia juaj atje a mendoni se Afganistani do të kthehet përsëri në një vatër aktive për grupet terroriste?

Ne shpresojmë të mos kthehet. Por gjasat janë që edhe mund të kthehet sepse kur një shtet drejtohet nga terroristët, mendoj se ekziston mundësia se do të ketë strehë për terroristët në Afganistan për shumë grupe terroriste. Shpresoj mos të ketë por është e pritshme edhe të ketë prapë.

A ju vjen keq që përkthyesit afganë, përfshi ata që ndihmuan misionet shqiptare atje kanë mbetur pa u evakuuar tashmë dhe u rrezikohet jeta?

Më vjen shumë keq, sepse përkthyesit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm për përmbushjen e misioneve tona speciale në Afganistan. Përkthyesit ishin krahu jonë i djathtë. Pa një përkthyes ti nuk kishte kishte si komunikojë me popullsinë, kryetarët e fshatrave, me komandantët e ushtrisë dhe policisë. Më vjen keq që kanë mbetur atje pasi kanë qenë shumë besnikë ndaj nesh në misionet tona. Që kur ne ishim atje ata ishin të kërcënuar por të sigurt nga prezencja e jonë. Do kisha pasur shumë dëshirë që përkthyesit e njerëzit që na kanë shërbyer koalicionit të NATO-s të ishin evakuuar e shpëtuar, pasi janë në rrezik shumë të madh.

Qendra e Personel Rekrutimit

Akademitë Ushtarake të Turqisë
kërkojnë 5 kandidatë për studime*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit deri më 14 shtator 2021*

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Turqisë, 5 (pesë) të drejta studimi si më poshtë vijon:

Akademia Ushtarake e Forcës Tokësore, 1 (një) kuotë. Akademia Ushtarake e Forcës Detare, 1 (një) kuotë. Akademia Ushtarake e Forcës Ajrore, 1 (një) kuotë. Fakulteti i Mjekësisë "GATA", 2 (dy) kuota.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 14 shtator 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake në Turqi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare mbi 8 (tetë), mesatarja e notave të të gjitha viteve të gjimnazit për lëndët Matematikë, Fizikë dhe Kimi të jetë mbi 8 (tetë) dhe notat e maturës shtetërore të jenë mbi 8 (tetë). Të mos jetë i martuar, i fejuar, i ve ose të mos bashkëjetojë. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen, të mos ketë tatuazhe ne pjesët e trupit, të mos jetë dystaban, të mos ketë në trup plagë apo shenja djegie, të jetë me flokë dhe të mos ketë sëmundje të lëkurës, si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës,



veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim pranimit në shkolla ushtarake. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a. Kanë kryer më parë të njëjtin nivel ar-



simor ushtarak brenda ose jashtë vendit. b. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përm-

dura më sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e

mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të Turqisë dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet; Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave; Fotokopje e kartës së identitetit; Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë; Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit; Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike; Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve: Dëshmi penaliteti; Vërtetim nga gjykata; Vërtetim nga prokuroria; Vërtetim nga përbarimi; Ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake; Testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj (anglisht): 15.09.2021; Testi Fizik: 15.09.2021; Testi Intelektual: 16.09.2021; Testi Psikologjik: 16.09.2021. Kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen edhe një testi intelektual (vlerësimi të nivelit të njohurive shkencore), që do të zhvillohet nga Zyra e Atasheut Ushtarak të Turqisë, i cili është s' kualifikues.



Kriza në Afganistan nuk ndryshon nevojën themelore për të qëndruar së bashku

Qëllimi i NATO -s është një botë pa armë bërthamore

MSC. MIMOZA GOLIKJA

guesit ndërkom-bëtarë që mbikëqyrin zbatimin e planit të paqes. Së fundi, Operacioni Aleate Harmonia filloi në dhjetor 2002 për të siguruar elementë këshillues për të ndihmuar qeverinë në sigurimin e stabilitetit në të gjithë vendin. Këto operacione demonstuan bashkëpunimin e fortë ndërinstitutional midis NATO-s, BE dhe OSBE. Në prill 2002, Shtabi i NATO -s Shkup u krijua për të këshilluar mbi aspektet ushtarake të reformës në sektorin e sigurisë; ajo u zvogëluar në 2012, duke u bërë Zyra Ndërlidhëse e NATO -s (NLO) Shkup, e cila nga ana tjetër u mbyll zyrtarisht një vit pas pranimit të vendit në NATO, në mars 2021.


Operacioni i parë antiterror i NATO-s

Më 4 tetor 2001, pasi u përcaktua se sulmet terroriste të 11 shtatorit në Nju Jork dhe Uashington DC kishin ardhur nga jashtë, NATO ra dakord për një paketë prej tetë masash për të mbështetur Shtetet e Bashkuara. Me kërkesë të Shteteve të Bashkuara, Aleanca nisi operacionin e saj të parë kundër terrorizmit-Operacioni Eagle Assist-nga mesi i tetorit 2001 deri në mes të majit 2002.

Ai përbëhej nga shtatë avionë radarë të NATO -s AWACS që ndihmuar në patrullimin e qiellit mbi Shtetet e Bashkuara; gjithsej 830 anëtarë të ekuipazhit nga 13 vende të NATO -s fluturuan mbi 360 fluturime. Kjo ishte hera e parë që asetet ushtarake të NATO -s u vendosën në mbështetje të një operacioni të Nenit 5.

NATO në Bosnjë dhe Hercegovinë

Me shpërbërjen e Jugosllavisë, konflikti i dhunshëm filloi në Bosnjë dhe Hercegovinë në prill 1992. Aleanca u përgjigj që në verën e vitit 1992 kur zbatoi embargon e armëve të OKB-së ndaj armëve në Detin Adriatik (në bashkëpunim me Bashkimin Evropian Perëndimor nga 1993) dhe zbatoi një zonë ndalimi të fluturimit të deklaruar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Gjatë monitorimit të zonës së ndalimit të fluturimit, NATO u angazhua në operacionet e para luftarake në historinë e saj duke rrëzuar katër luftëtarë-bombardues serbë të Bosnjës që kryenin një mision bombardues më 28 shkurt 1994. Në gusht 1995, për t'i dhënë fund dhunës së udhëhequr nga serbët në vend, paqeruajtësit e OKB-së kërkuan sulme ajrore të NATO-s. Operacioni Deadeye filloi më 30 gusht kundër forcave ajrore serbe të Bosnjës, por nuk arriti të rezultojë në pajtueshmërinë e serbëve të Bosnjës me kërkesat e OKB-së për t'u tërhequr. Kjo çoi në Operacionin Forca e qëllimshme, e cila kishte në shënjestër instalimet dhe objektet e municionit të komandës dhe kontrollit të serbëve të Bosnjës. Kjo fushatë ajrore e NATO -s ishte një faktor kyç në sjelljen e serbëve në tryezën e bisedimeve dhe përfundimin e luftës në Bosnjë.Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit në dhjetor 1995, NATO vendosi menjëherë një Forcë Zbatuese të mandatuar nga OKB-ja (IFOR) që përfshinte rreth 60,000 trupa. Ky operacion (Operacioni Përpjekje e Përbashkët) u pasua në dhjetor 1996 nga vendosja e një Force Stabilizimi prej 32,000 trupash (SFOR). Në dritën e situatës së përmirësuar të sigurisë, NATO përfundoi operacionin e saj për mbështetjen e paqes në dhjetor 2004 dhe Bashkimi Evropian vendosi një forcë të re të quajtur Operacioni Althea. Aleanca ka mbajtur një seli ushtarake në vend për të kryer një numër detyrash specifike të lidhura, në veçanti, për të ndihmuar qeverinë në reformimin e strukturave të saj mbrojtëse.



Ministri Mehaj dhe znj. Graham nënshkruan marrëveshjen e re të bashkëpunimit ndërinstitucional, respektivisht aktin e pranim-dorëzimit të donacionit të ri në pajisjet specialistike për nevojat e Qendrës sonë Rajonale Trajnuese të Kërkim-Shpëtimit. Në vazhdim, znj. Graham me stafin e saj, u takua edhe me zv. komandantin e FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqin, i cili e informoi me procesin dhe shkallën e realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së dhe atë të realizimit të objektivave operacional të Ministrisë.



Bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

Ministri Mehaj priti në takim shëfën për Politikë të Gjerë Evropiane të Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në takim, shëfën për Politikë të Gjerë Evropiane në Ministrinë e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, znj. Sarah Graham në datën 3 shtator 2021. Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes ka shprehur falënderimet dhe mirënjohjen më të lartë për përkrahjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar në të gjitha fushat e posaçërisht në fushën e arsimit dhe stërvitjes së pjesëtarëve të FSK-së në akademitë dhe qendrat trajnuese më prestigjioze britanike, si dhe përkrahjen me asistencë teknike të stafit të Ministrisë së Mbrojtjes, në proceset e prokurimit dhe llogaridhënies publike. Nga ana e saj, znj. Graham, konfirmoi mbështetjen për Ministrinë e Mbrojtjes në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe atyre operacionale të FSK-së, si dhe aspekteve të tjera bilaterale që pritet të formalizohen me rastin e vizitës së Ministrisë Mehaj në Mbretërinë e Bashkuar në javët e ardhshme. Në fund të dy u pajtuan për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, posaçërisht në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, programeve të arsimit dhe stërvitjes si dhe promovimit të politikave të barazisë gjinore dhe integritetit të mëtejshëm të komuniteteve jo shumicë në FSK. Pas takimit, Ministri Mehaj dhe znj. Graham nënshkruan marrëveshjen e re të bashkëpunimit ndërinstitucional, respektivisht aktin e pranim-dorëzimit të donacionit të ri në pajisjet specialistike për nevojat e Qendrës sonë Rajonale Trajnuese të



Kërkim-Shpëtimit. Në vazhdim, znj. Graham me stafin e saj, u takua edhe me zv. komandantin e FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqin, i cili e informoi me procesin dhe shkallën e realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit të FSK-së dhe atë të realizimit të objektivave operacional të Ministrisë. Më pas, gjeneral Cikaqi e shoqëroi znj. Graham në vizitën e saj në Shtabin e Përgjithshëm ku u prit nga gjeneral brigadë Jeton Dreshaj dhe stafi i tij. Me këtë rast,

gjeneral Dreshaj e njoftoi me misionin, strukturën, orientimin e aftësive, sfidat si dhe me bashkëpunimin e deritanishëm me Mbretërinë e Bashkuar.

Znj. Graham, në fund takoi edhe Zv. Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Mbrojtjes, znj. Fahrije Sadiku, ku u njoftua me zhvillimet e përgjithshme në sistemin e administratës, zhvillimet në proces dhe ato në të ardhmen në funksion të realizimit të qëllimeve strategjike të Ministrisë Mehaj.

MEDALJA “SHËRBIM I SHQUAR”

Ministri Mehaj dekoron kolonelin amerikan, William Woodrad

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i shoqëruar nga zëvendës-komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, priti në 6 shtator 2021, në takim të lamtumirës shëfën e këshilltarëve të NALT-it, kolonelin amerikan, William Woodrad. Me këtë rast, ministri Mehaj, e dekoroi kolonelin Woodrad me medaljen “Shërbim i shquar” për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe avancimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, gjatë kohës sa ka shërbyer në NALT. Në këtë takim të lamtumirës, ministri Mehaj shprehur mirënjohjen e thellë për angazhimin e kolonelin Woodard, përveç tjerash, edhe në koordinimin efektiv me NALT, duke besuar se një bashkëpunim i ngjashëm do të vazhdojë edhe më tutje nga pasardhësi i tij, i cili pritet të emërohet së shpejti. Gjithashtu, edhe gjeneralmajor Enver Cikaqi, me motivacion për vizion strategjik, udhëheqje dhe përkushtim të lartë në zhvillimin e FSK-së, e dekoroi kolonelin Woodard me medaljen “Shërbim vetëmohues”. Nga ana e tij, kolonelin Woodard vlerësoi lart arritjet e deritanishme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së duke shprehur besimin në realizimin e suksesshëm të vizionit të ministrit të Mbrojtjes.

FSK shembull i përkushtimit dhe angazhimit profesional në operacionin humanitar për pritjen e refugjatëve afgan

FSK me aftësitë dhe kapacitetet e specializuara operacionale të saj, prej datës 29 gusht të këtij viti, është e angazhuar në operacionin humanitar shumëkombësh të NATO-s të udhëhequr nga SHBA, për transportin, pritjen, akomodimin dhe sigurinë e refugjatëve afgan. Ministria e Mbrojtjes ka angazhuar efektivat e specializuar të rendit, sigurisë, mjekësisë, të mbështetjes logjistike dhe transportit të FSK-së në kuadër të Task-Forcës së përbërë nga institucionet qeveritare vendore, si pjesë e operacionit përkatës. Ministri Mehaj ka përcaktuar me prioritet, angazhimin e të gjitha aftësive dhe kapaciteteve operacionale në dispozicion për Task-Forcën për realizimin e suksesshëm të këtij operacioni. Besimi i partnerëve tanë strategjik në aftësitë dhe profesionalizimin e FSK-së, për të qenë pjesë e operacionit të përbashkët, është shumë domethënëse. Gjithashtu, shumë i rëndësishëm është edhe vlerësimi shumë i lartë i autoriteteve përgjegjëse të NATO-s për performancën e deritanishme të treguar nga efektivët e FSK-së për operacionin në Kosovë, FSK, sikur edhe më parë, edhe në operacionin aktual, dëshmon fuqishëm nivelin e gatishmërisë operacionale për ndërveprim të suksesshëm me forcat aleate në operacionet e ardhshme humanitare shumëkombëshe dhe operacione tjera të paqes. Deri sa operacioni është duke u realizuar me sukses, ministri Mehaj shpreh vullnetin e fuqishëm që të vazhdojë përkrahjen e plotë për NATO-n. Gjithashtu, ai shpreh qëndrimin e fuqishëm se sikur tani dhe në secilën situatë tjetër, Republika e Kosovës, qytetarët dhe ushtarët e saj do të jenë në përkrahje të pakursyer të SHBA-së, si partneri ynë i pazëvendësueshëm strategjik. Angazhimi me përkushtim maksimal në operacionin humanitar për pritjen e refugjatëve afgan, përveç përkushtimit të veprimit në aleancë me partnerët tanë, është edhe demonstrim i vlerave kulturore, historike të mikpritjes tradicionale të shqiptarëve me moton “Shtëpia jonë është e Zotit dhe mikut”.


Ministri Mehaj priti ministrin e Mbrojtjes të Letonisë, Artis Pabriks

Ofrimi i përvojës së Letonisë në procesin e anëtarësimit në NATO dhe shkëmbimi i përvojave

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, priti me nderime të larta ushtarake homologun e tij nga Letonia, ministrin Artis Pabriks në datën 8 shtator 2021. Duke i uruar mirëseardhjen ministrit Pabriks dhe delegacionit të tij, ministri Mehaj shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e lartë për kontributin e shtetit dhe kombit letonez për sigurinë e Republikës së Kosovës me kontingjentin e saj në kuadër të KFOR-it. Në takimin mes dy ministrave u diskutua për çështjet e interesit të përbashkët të të dyja vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ata u dakorduan që ky bashkëpunim të in-

tensifikohet dhe konkretizohet me plane të qarta të aktiviteteve të përbashkëta. “Për ne që jemi në fazën e zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale, përvoja e Republikës së Letonisë, si vend anëtar i NATO-s është shumë e rëndësishme. Bashkëpunimi ynë do të shtrihet në fusha të ndryshme, por me fokus do të jenë ofrimi i përvojës së Letonisë në procesin e anëtarësimit në NATO, operacioneve paqeruajtëse, si dhe shkëmbimi i përvojave në fushat specialistike mes dy forcave”, tha ministri Mehaj. Nga ana e tij, përveç tjerash, ministri Pabriks, theksoi vullnetin e tij

dhe qeverisë letoneze për thellimin e bashkëpunimit bilateral dhe ofrimin e kontributit nga kapacitetet e tyre në realizimin e synimeve strategjike të Republikës së Kosovës dhe qeverisë së saj për anëtarësim në NATO dhe BE, si dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Në fund të këtij takimi, të dy ministrat u pajtuan që ekipet e të dyja vendeve në nivel të ekspertëve të angazhohen intenzivisht për Marrëveshjen e re bilaterale, për zhvillim e kapaciteteve të ndërsjella në funksion dhe shërbim të sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë.



“Na u dhanë pak shanse për sukses, vlerësimi kryesor ishte se konfliktet e shumta në të gjithë Jugosllavinë nuk do të na kalonin, dhe ky mund të jetë fundi i vendit. Dhe kjo është arsyeja pse unë mendoj se arritja është më e madhe me të gjitha momentet e gëzimit dhe pikëllimit, sepse në 30 vitet e fundit ne kemi formuar institucione pothuajse nga e para, kemi ndërtuar shtet dhe jemi më të fortë”, -tha ministrja.



Shekerinska në konferencën e NATO 2030 dhe 30-vjetorin e pavarësisë: Ne ndërtuam një vend me të gjitha atributet që u bë anëtar i NATO-s

“Anëtarësimi në NATO është kurora e 30 viteve tona të pavarësisë”, -tha më 3 shtator ministrja Radmilla Shekerinska në konferencën në Ohër, kushtuar agjendës së NATO 2030 dhe 30-vjetorit të pavarësisë.

Shekerinska u ndal edhe në skepticizmin në disa qarqe, kur 30 vjet më parë Maqedonia në atë kohë shpalli pavarësinë e saj.

“Na u dhanë pak shanse për sukses, vlerësimi kryesor ishte se konfliktet e shumta në të gjithë Jugosllavinë nuk do të na kalonin, dhe ky mund të jetë fundi i vendit. Dhe kjo është arsyeja pse unë mendoj se arritja është më e madhe me të gjitha momentet e gëzimit dhe pikëllimit, sepse në 30 vitet e fundit ne kemi formuar institucione pothuajse nga e para, kemi ndërtuar shtet dhe jemi më të fortë”, -tha ministrja.

Shekerinska tha gjithashtu se anëtarësimi në NATO e forcon atë sovranitet dhe shton ambicien tonë në aspekt të shtetit që duam ta krijojmë.

Sa i përket Afganistanit, ministrja nënvizoi se si vend kemi vendosur të jemi në krah të vlerave demokratike, mbështetjen e normave që ne i konsiderojmë si civilizuese, të cilat prekën veçanërisht gratë dhe fëmijët në Afganistan.

“Ne jemi të gatshëm të solidarizohemi dhe të pranojmë një numër të caktuar të qytetarëve të evakuuar të Afganistanit, jo për shkak të anëtarësimit tonë në NATO, por edhe sepse kemi qenë atje për një kohë të gjatë, kemi qenë të angazhuar dhe nuk duam ta harrojmë të gjithë këtë në momentin kur ndodh një krizë e vërtetë. “Ne



mendojmë se kjo është një situatë që kërkon humanizëm, dhe jo të injorojmë vuajtjet e njerëzve të cilët kanë ndodhur vetëm dhe do të jenë nën sulmin e qeverisë talebane,” -tha Shekerinska. Konferenca dy-ditore e mbajtur sot dhe nesër në Ohër me pjesëmarr-

rës të shumtë nga jeta politike dhe publike, ekspertë dhe mysafirë të huaj, është hyrje në festimin e 30-vjetorit të pavarësisë së vendit tonë, e cila do të pasohet nga një sërë ngjarjesh të tjera në periudhën deri në Ditën e Pavarësisë, 8 Shtator.

Takim i Shekerinskës me admiralin Burk në Napoli

Maqedonia e Veriut një aleat i besueshëm i NATO-s

“Ne, nuk e kuptojmë anëtarësimin në NATO vetëm si një privilegj, por edhe si përgjegjësi dhe mundësi për të dhënë kontribut në paqen dhe sigurinë në botë dhe në rajon. Prandaj jemi krenar në pjesëmarrjen tonë në misionin KFOR në Kosovë, sepse në këtë mënyrë rajoni ndjen më direkt benefitet nga anëtarësimi i vendit tonë në NATO, ndërsa NATO ka fituar një aleat, politika konstruktive e të cilit është e njohur që më parë në rajon dhe më gjerë”, -tha ministrja Radmilla Shekerinska në takimin e datës 2 shtator 2021 në Napoli me komandantin e Komandës Aleate të Forcave të Përbashkëta të NATO-s, admiralin Robert Burk. Biseda u përqendrua gjithashtu në situatën në botë, duke iu referuar Afganistanit, dhe situatën në rajon ku vendi ynë si anëtar i NATO-s kontribuon drejtpërdrejt në paqe dhe stabilitet, për të cilat mori vlerësime pozitive nga Aleanca.



Shekerinska u përshëndet në bazën e NATO-s me një kordon të veçantë duke mirëpritur praninë e saj në selinë e një prej komandave më të rëndësishme të Aleancës. Delegacioni nga Ministria e Mbrojtjes dhe Armata, i udhëhequr nga ministrja Shekerinska, gjithashtu pati takime në drejtoritë për stërvitje dhe operacione ku u informuan për aktivitetet dhe planet e Komandës Aleate.

Konferenca “Rimëkëmbja dhe rritja ekonomike pas Covid-19”

Shekerinska: Të luftojmë pabarazinë dhe korrupsionin dhe të jemi inovativ në politikat tona

“Pandemia e koronavirusit ka treguar se bota mund të jetë shumë kreative dhe shumë e shpejtë në përshtatjen dhe bashkëpunimin në kohë krize ekzistenciale. Ne kemi nevojë për të njëjtin kreativitet dhe bashkëpunim për të qenë në gjendje të përballojmë sfidat e të ashtuquajturës bota pas COVID-it”, -tha ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në datën 7 shtator 2021, në panelin kushtuar sfidave globale dhe rajonale dhe perspektivës për rimëkëmbjen dhe rritjen, e cila ishte pjesë e Konferencës së Parë Vjetore mbi “Rimëkëmbjen dhe Rritjen Ekonomike pas Covid-it”, organizuar nga Ministria e Financave.

Ministrja Shekerinska tha se ky është momenti kur shumica e ekonomistëve dhe politikanëve bien dakord se kthimi në normalitet nuk është një opsion kur bëhet fjalë për politikat shtetërore, politikën në përgjithësi dhe ekonominë në veçanti.

“Ne duhet të krijojmë një botë më të barabartë, të krijojmë një ekonomi e cila do të jetë më pak e varur nga qymyri, të ndërtojmë infrastrukturë moderne, kujdes shëndetësor universal, të krijojmë rregulla të koordinuara për epokën

dixhitale dhe, pavarësisht qëllimit tonë kryesor për të luftuar ndryshimet klimatike, ne duhet të planifikojmë se si do të merremi me efektet e ndryshimit të klimës me të cilat tashmë po përballemi, si zjarret dhe përmytjet. Kjo kërkon një rishikim të përgjithshëm të të gjitha sistemeve tona, duke filluar me sigurinë, por që mbulon shumë fusha të tjera. “Veprimi në mënyrën e vjetër nuk është më një opsion,” -tha ministrja.

Si shembull i ndryshimeve të nevojshme, Shekerinska vuri në dukje subvencionet për ekonominë, të cilat duhet të sigurojnë një dukshmëri më të madhe të prioritetëve tona politike dhe qytetëruese.

“Unë besoj se do të kemi një mundësi të humbur nëse nuk kombinojmë subvencionet e forta që kemi dhënë dhe ua japim kompanive me përgjegjësi më të madhe shoqërore në lidhje me mjedisin, modele më të mira sociale, një sistem që do ta përdorim si pjesë e buxhetit që sërish të rishikojmë sistemet tona tatimore, politikat e të ardhurave dhe politikat që do të çojnë në përmirësimin e standardit,” -tha ministrja Shekerinska.

Anëtarësimi i vendit tonë në NATO, i

cili ishte një sukses i madh historik, ishte gjithashtu i mirëpritur për ekonominë, edhe në kohë krize,” -tha ajo, duke shtuar se aty ku duhet të përqendrohem tani është rritja e rezistencës së shoqërisë.

“Shoqëritë tona përballen me rritjen e liberalizmit, paqëndrueshmërinë e identitetit perëndimor, dhe kjo është arsyeja pse ne duhet t'i bëjmë shoqëritë dhe institucionet më rezistente, sepse përndryshe gjithçka që bëhet në sektorin e mbrojtjes nuk do të jetë e mjaftueshme,” -tha ministrja dhe përmbylli me “po” për të luftuar pabarazinë, “po” për të luftuar korrupsionin, “po” për të analizuar të gjitha rregullat që ishin tipike për sistemin tonë dy vjet më parë. Le të jemi më kreativ dhe të shikojmë fotografinë e madhe gjatë gjithë kohës.

Në diskutim në panel u drejtuan gjithashtu edhe Anna Bjerde, nënkryetare e Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore, Kate Mary Burns, ambasadorja amerikane, Andrew White nga Universiteti i Oksfordit, Artan Grubi, zëvendëskryeministër, Majlinda Bregu, Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RSS), si dhe Haoliang Hu i UNDP.

Certifikatë Mirënjohjeje nga Agjencia për Siguri Kombëtare për Sektorin për Siguri Ushtarake dhe Inteligjencë

Sektorin për Siguri Ushtarake dhe Inteligjencë (SSUI), pranë Ministrisë së Mbrojtjes u nderua, në 2 shtator 2021, me një Certifikatë Mirënjohjeje nga Agjencia për Siguri Kombëtare (ASK) për bashkëpunimin e suksesshëm mes dy shërbimeve të sigurisë deri më sot.

Certifikata e Mirënjohjes u pranua nga Shefi i SSUI, kolonel Goran Vasilevski.

“Ky është një motiv tjetër për ne që të vazhdojmë punën tonë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatë, si dhe bashkëpunimin me kolegët tanë nga sektori i sigurisë në vend”, -tha koloneli Vasilevski. Certifikata e Mirënjohjes u nda nga Drejtori i ASK, Viktor Dimovski, në kuadër të festimit të përvjetorit të dytë nga themelimi dhe funksionimi i agjencisë kombëtare. Ceremonia u mbajt në Klubin e Deputetëve, ku morën pjesë figura të larta nga udhëheqja politike dhe e sigurisë së vendit. Certifikatat e Mirënjohjes dhe mirënjohje të tjera iu prezantuan gjithashtu organizatave dhe drejtuesve të tjerë në fushën e sigurisë.



Ambasadorja Mustafa vuri në dukje interesin e palës amerikane për nënshkrimin e një Marrëveshjeje Administrative (AA) me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes, e cila do t'i lejojë Shtetet e Bashkuara të marrin pjesë në zbatimin e projekteve nën Nismën e Bashkëpunimit të Strukturuar të Përhershëm të BE -së (PESCO).



Projekte për modernizimin e Forcave të Armatosura dhe blerjen e radarëve të rinj 3D

Ministri i Mbrojtjes Georgi Panajotov diskuton çështjet e bashkëpunimit dypalësh me ambasadorin amerikan në Bullgari

Në kuadër të bashkëpunimit të vendosur të mirë midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ambasadorës Amerikane, në 9 shtator 2021 u mbajt një takim midis Ministrit të Mbrojtjes Georgi Panajotov dhe Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të SHBA në Republikën e Bullgarisë HE Zonja Hero Mustafa. Shefi i Mbrojtjes, Admirali Emil Eftimov, gjithashtu mori pjesë në takim. Gjatë bisedimeve dypalëshe, u diskutuan tema që lidhen me zhvillimin e projekteve për modernizimin e Forcave të Armatosura Bullgare, në veçanti blerjen e radarëve të rinj 3D, si dhe mundësitë për kryerjen e iniciativave në fushën e mbrojtjes kibernetike. Të dy palët shkëmbyen gjithashtu mendime mbi çështjet aktuale në lidhje me pajisjet e disponueshme të aviacionit në Ushtrinë Bullgare. Ambasadorja Mustafa vuri në dukje interesin e palës amerikane për nënshkrimin e një Marrëveshjeje Administrative (AA) me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes, e cila do t'i lejojë Shtetet e Bashkuara të marrin pjesë në zbatimin e projekteve nën Nismën e Bashkëpunimit të Strukturuar të Përhershëm të BE -së (PESCO). Takimi diskutoi



gjithashtu mundësitë për kryerjen e një rishikimi të përparitimit të bërë në zbatimin e prioriteteve të përcaktuara në "Udhërrëfyesin

për Bashkëpunimin e Mbrojtjes midis Republikës së Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara (2020-2030)" nënshkruar në tetor 2020.

Qitje të përbashkëta në poligonin Shabla

Ekipe serbe të MiG-29 u zhvendosën në bazën ajrore Graf Ignatievo

Tre avionë MiG-29 të Forcave Ajrore të Republikës së Serbisë u ulën në Bazën Ajrore Graf Ignatievo më 5 shtator 2021, për të marrë pjesë në fluturime të përbashkëta mbi det. Ato do të mbahen në kuadrin e të shtënave luftarake eksperimentale dhe të përbashkëta me pjesëmarrje ndërkombëtare "Shabla 2021-2". Më herët gjatë ditës, një pjesë e stafit fluturues, inxhinierik dhe ndihmës të fqinjët bullgar perëndimor mbërriti me dy helikopterë Mi-17. Ushtarakët janë të përfshirë në përgatitjen dhe pjesëmarrjen e avionëve luftarakë serbë për të shtënat luftarake ndaj objektivave ajrorë në poligonin kundërajror të Forcave Ajrore Shabla. Qitje eksperimentale dhe të përbashkëta luftarake me pjesëmarrje ndërkombëtare "Shabla 2021 - 2" do të mbahet në periudhën nga 8 deri më 11 shtator 2021 (dita e rezervimit 12 shtator 2021). Ato do të përfshijnë formacione raketash kundërajrore dhe aviacion nga Forcat Ajrore Bullgare dhe Serbe, si dhe formacione nga Forcat Tokësore dhe Marinën nga Ushtria Bullgare.

152 ushtarakë të sapoemëruar në Ushtrinë Bullgare bënë betimin ushtarak

Në prag të 136 vjetorit të Bashkimit të Principatës së Bullgarisë me Rumelinë Lindore, 152 ushtarakë të caktuar në formacionet ushtarake të Ushtrisë Bullgare bënë solemnisht betimin ushtarak.

Përpara monumentit të Borimechka mbi qytetin e Klisura-s, më 3 shtator, 124 ushtarakë nga brigada e 61-të e mekanizuar u betuan për besnikëri ndaj familjes dhe Atdheut. Ata bënë betimin ushtarak në një vend të shenjtë të njomur në gjakun e heronjve që vdiqën për lirinë e atdheut. Në përshëndetjen e tij, komandanti i Brigadës 61 të Mekanizuar, gjeneralbrigade Deyan Deshkov, u bëri thirrje ushtarëve të rinj të mbajnë emrin e shenjtë të Bullgarisë dhe të ndjekin shembullin e paraardhësve të tyre, të cilët shërbyen me krenari në radhët e Brigadës së 61-të të Mekanizuar. Para monumentit të Borimechka, u këndua himni i Republikës së Bullgarisë nga ushtarakët e sapoardhur, të cilët marshuan para mysafirëve, prindërve dhe të afërmeve.

Në ritualin solemn morën pjesë Velizar Shalamanov dhe Veska Nencheva - deputetë nga Asambleja e 46-të Kombëtare, Donyo Todorov - Kryetar i Këshillit Komunal të Karlovo,



Genka Todorova - Kryetare e Klisura, përfaqësues të organizatave ushtarako-patriotike, prindër dhe të afërm.

Një ritual solemn i shërbimit ushtarak u krye më 2 shtator nga 28 ushtarë të sapoemëruar në CIS Mobile. Shefi i Shtabit të Komandës së Forcave të Përbashkëta, gjeneralbrigade Valentin Krastev, iu drejtua atyre me fjalët: "Sot ju, ushtarët e rinj nga Mobile CIS, po filloni rrugën tuaj profesionale në Ushtrinë Bullgare. Para prindërve, të afërmeve dhe miqve tuaj, ju u betuat për të mbrojtur kufijtë e pacenueshëm dhe pavarësinë e

vendit tonë, siç i mbrojtën paraardhësit tanë, në mënyrë që Bullgaria ta ketë atë përgjithmonë. Do të përballeni me shumë sfida, punë të palodhur, ditë pune dhe pushime të ngarkuara për të fituar trajnimin dhe njohuritë e nevojshme për të përfunduar me sukses detyrat. Vishni uniformën tuaj ushtarake me krenari, jini të ndershëm dhe të disiplinuar, këmbëngulës dhe të përkushtuar, të patundur, të sigurt dhe luftarakë.

Të ftuar të ceremonisë ishin përfaqësues të autoriteteve lokale, të afërm dhe miq të ushtarëve të rinj.

Stërvitja "Thracian Summer 2021"

Ushtarët nga Komanda e Përbashkët e Operacioneve Speciale përmirësuan aftësitë e tyre luftarake

Më shumë se 100 ushtarakë nga Komanda e Përbashkët e Operacioneve Speciale morën pjesë në stërvitjen "Thracian Summer 2021" në periudhën 24 gusht - 1 shtator 2021 në Aeroportin Cheshnegirovo. Për herë të parë, hedhjet bullgare-amerikane nga lartësitë e mëdha u kryen me parashutë manuale që shpalojse brenda stërvitjeve taktike.

Personeli i Forcave Speciale pati mundësinë të planifikojë dhe kryejë disa operacione speciale: të kërkojë dhe të shpëtojë një pilot të katapultuar në një zonë të kontrolluar nga forcat kundërshtarë; për lirinë e pengjeve duke përdorur taktika, teknika dhe procedura për luftime në ambiente të mbyllura dhe për sigurimin e ndihmës mjekësore dhe evakuimin nga avionët C-130 për shumë të plagosur pas një sulmi të armatosur në një bazë operacionale të Aleatëve. Në kryerjen e këtyre detyrave, të gjitha ekipet u hodhën me parashutë.

Në kuadër të stërvitjes u arritën qëllimet e përcaktuara, për të përmirësuar aftësitë dhe zakonet e parashutistëve në kryerjen e llojeve të ndryshme të kërcimeve me parashutë ditën dhe natën, si dhe në ulje në mënyra të ndryshme, për të rritur nivelin e ndërveprimit gjatë pjesëmarrjeve në bashkime detyrash me një komponent të aviacionit të përbërë nga avionët të një partneri aleati/koalicioni, si dhe për të unifikuar procedurat standarde të funksionimit për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e operacioneve speciale.

Mbi shtypin partizan gjatë LANÇ-it



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Nga traktet e thjeshtë drejt shtypit të organizuar

Shtypi gjatë LANÇ-it doli në një periudhë të vështirë për popullin shqiptar. Atdheu ishte i pushtuar nga Italia fashiste, që i kishte vënë vetes detyrë ta fashistozonte Shqipërinë dhe ta kthente në një bazë për planet e saj agresive në Ballkan dhe më gjerë. Pushtuesit fashistë në bashkëpunim me qeverinë kuislinge e tradhtarët e vendit financuan e botuan një numër të madh gazetash e revistash. Kundërvënja ndaj propagandës dhe fushatës demagogjike të shtypit profashist, si dhe demaskimi i manovrave të tyre politike ishte një ndër detyrat madhore të shtypit të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gazetat më të thjeshta që qubeshin gazeta xhepi, nxirreshin periodikisht nga njësitë partizane, ku analizohesh kryerja e detyrave luftarake, përgjithësohej përvoja pozitive, kritikoheshin mangësitë, evidentoheshin mjeshtrëria luftarake dhe aftësitë drejtuese të luftëtarëve e kuadrove, si dhe shpalosej trimëria dhe heroizmi partizan e sidomos i dëshmorëve.

Agjitacioni i vogël gojor, parullat e shkruara herë pas here nëpër mure e sheshe publike si edhe ndonjë trakt, ishin krejtësisht të pamjaftueshme për të përballuar fushatën mashtruese të gjithë atij shtypi të përditshëm e periodik që organizoi fashizmi Italian sapo shkeli në vendin tonë. Në një dokument të parë masiv thuhet se: "Lufta jonë nacionalçlirimtare ka filluar"; "duke iu drejtuar të gjithë shqiptarëve të ndershëm, që duan me të vërtetë Shqipërinë, të bashkojnë të gjitha forcat për t'i vënë në shërbim të luftës për çlirim kombëtar". Thirrje e trakte të ndryshme kanë dalë: në shkurt 1942 që u drejtohej ushtarakëve, në prill 1942 që i drejtohej punëtorëve, në korrik 1942 që i drejtohej fshatarësisë etj. Dalja në dritë e këtyre dokumenteve, në kushtet e një reaksioni të egër dhe të ndjekjes e të persekutimit të çdo mendimi e ideje që i kundërvijehesh pushtimit fashist dhe politikës së tij, ishte një sfidë e rëndë për propagandën e tij. Në një thirrje theksohet: "Ti, intelektual i ndershëm, mos u veço, forco radhët e luftëtarëve të lirisë, me veprën tënde merr pjesë në kryqëzatën kundër fashizmit për çlirim e atdheut". Në shumë trakte flitet për luftën dhe qëndrimin heroik të të rinjve. Ato nuk përshkohen nga fryma e vajimit, e përkuljes edhe kur humbja është e rëndë, po nga vendosmëria për qëndresë e hakmarrje si në rastin e rënies së Qemal Stafës, të Misto Mames etj. Çlirimi me çdo kusht i Atdheut nuk është shtruar asnjëherë si diçka që do të vinte nga jashtë, por gjithmonë si rezultat i luftës së vendosur që do të bënte popullin ynë. Me vëmendje është propaganduar lufta e popujve fqinj. Thëniet e armikut mbi të ashtuquajturën "rrezik serb e grek", janë hedhur poshtë me përbuzje, si synime të pushtuesve për të përçarë popujt e robëruar, që ata t'i sundonin më lehtë. Aleanca anglo-sovjeto-amerikane është trajtuar drejt, si një "aleancë popujsh".



Duke pasur këtë tipar karakteristik, me tonin e tyre luftarak, me parullat mobilizuese, me një gjuhë të thjeshtë dhe komunikuese, traktet kanë prekur ato probleme që ishin në shpirtin dhe në zemrën e popullit patriot siç ishin Atdheu, nderi, liria, pavarësia, familja, e ardhmja e tyre. Kështu traktet kanë luajtur rolin e një armë me qitje shpërthyes, që kanë goditur rëndë armikun dhe kanë shpartalluar planet e tij skllavëruese.

Tipar karakteristik, shpejtësia dhe operativiteti

Botimi i tyre në shumë raste brenda ditës ose disa orëve, pas një ngjarjeje të ndodhur, e kanë çoroditur armikun dhe e kanë demaskuar atë para opinionit të masave. Tipik është trakti i shtypur në Tiranë në shtypshkronjën e armikut, që njofton goditjen me top të Asamblesë së Gestapos. Ai është një trakt vetëm me 14 rreshta, por që i thotë të gjitha. Përdorimi i këtyre mjeteve për agjitacion e propagandë, për t'u lidhur e për të komunikuar me masat, në kushtet e vështira të luftës e të ilegalitetit të thellë të imponuar nga armiku, është një dëshmi e pjekurisë të atij brezi. Në të njëjtën kohë përgatitja dhe shpërndarja e tyre tregojnë vendosmërinë dhe guximin për ta përdorur këtë armë në kohën e duhur. Efekti i tyre në ngritjen e ndërgjegjes politike të masave ishte i jashtëzakonshëm. Roli i tyre për demaskimin e propagandës së armikut ishte dërmues.

Shtypi u mbryjt me aspiratat dhe shqetësimet e popullit, luftoi për to, zbuloi shtigje dhe çeli rrugë me thonj e me dhëmbë, kur erdhi puna, për t'iu dalë në krye detyrave dhe misionit të caktuar. Pikërisht pse ishte i tillë, ai fitoi që në fillim dashurinë dhe besimin e popullit dhe pati gjatë gjithë rrugës mbështetjen dhe ndihmën e tij pa rezervë. Pa përfillur vdekjen, qindra bij të popullit, anëtarë të njësiteve guerile, ndërmorën aksione nga më të guximshmet mbi zyra, depo e shtypshkronja të armikut, për të krijuar bazën materiale e teknike të shtypit.


Qindra të tjerë vunë jetën në rrezik për të transportuar nga njëri vend në tjetrin përmes terrorit dhe rojeve armike, teknikën dhe materialet e saj. Qindra familje të popullit nuk kursyen jetë, shtëpi e katandi, në qytete e në fshatra për t'i shndërruar banesat e tyre në baza aktive të kësaj teknike.

Mbi rolin e shtypit partizan

Shpërndarja dhe leximi në masë i shtypit ilegal ishte një aksion i përgjithshëm i popullit, që kryhej me kokë në torbë nën hundën e pushtuesit dhe të spiunëve të tij. Çfarë formash dhe mënyrash të mrekullueshme nuk krijoi mendja e popullit, guximi dhe besimi i tij në fitore e për të çuar deri në kasollen e izoluar të vendit zërin e luftës. Çfarë taktike të zgjuar nuk përdori ai për të fshehur nga syri i armikut shtypin e kohës. Parulla "Lexoje, shpërndaje dhe mos ia dorëzo armikut", që u bë motoja lëvizëse për shpërndarjen dhe përdorimin e të gjithë shtypit ilegal, e ka nismën e saj pikërisht edhe në vështirësitë dhe kushtet e vështira të luftës.

Në këto kushte u bë e mundur të botohen në ilegalitet disa organe si gazetat "Zëri i Popullit" e "Bashkimi", revista "Kushtrimi i Lirisë" organ i rinisë antifashiste shqiptare, "Gruaja shqiptare" dhe revista letrare "Liri" etj. Redaksitë e këtyre organeve shpesh botonin dhe shpërndanin edhe trakte antifashiste, buletine e komunikata operative luftime. "Zëri i Popullit" doli më 25 gusht 1942 në kushtet e një ilegaliteti të thellë, kur mjete të tjera të shtypit ilegal të LANÇ-it kishin filluar punën e tyre, kishin fituar besimin dhe mbështetjen e masave. "Kushtrimi i lirisë" i dalë në fund të gushtit 1942 shprehet me vendosmëri se "rinia shqiptare udhëhiqet

nga principi se fashizmi i mallkuem asht anniku i betueme i tanë breznisë së re, prandaj, duhet të japim të gjitha energjitë tona të reja në luftë për çlirim e popullit shqiptar ... luftë për një Shqipëri të pavarur dhe demokratike, luftë për çlirim e popullit shqiptar nga zgjedha fashiste". Gazeta "Bashkimi" që doli në mars 1943, organ i këshillave nacionalçlirimtare ngjalli gëzim dhe kënaqësinë e të gjithë patriotëve të ndershëm të vendit dhe brenda një kohe të shkurtër u bë zëdhënësi i ndjenjave, dëshirave dhe vendosmërisë së tyre për të luftuar me të gjitha mjetet, për krijimin e një "Shqipërie të lirë, të pavarur e demokratike".



Gazeta mbronte me forcë tezën se "liria nuk dhurohet, por fitohet". Ajo shpjegon se "Lirinë nuk kërkojmë ta fitojmë tue shtri dorën por do të arrijmë tue tregue grushtin, ashtu siç kemi dijtë ta kërkojmë gjatë shekujsh". Popullarizimi i luftës, i

vendosmërisë, guximit dhe sakrificave të partizanëve, janë objekt i artikujve dhe i komenteve të gazetës. Ajo i ngre lart dhe i mbron këto nga shpifjet e armiqve e të tradhtarëve. Ajo mbron tezën se "pa derdhur gjak liria nuk fitohet". Revista "Gruaja shqiptare" doli në korrik 1943 dhe ishte një pohim i kësaj pjesëmarrjeje, i personalitetit të saj politik dhe shoqëror dhe i vendosmërisë së saj për të ecur krah për krah me të gjithë popullin në luftën e madhe për çlirim kombëtar e shoqëror të vendit.

Pushtuesit dhe propaganda e tyre

Propaganda armike nuk ka qenë e dobët as në sasinë e mjeteve të saj, as në argumentet që përdorte për të mashtruar popullin e për ta tërhequr atë në vathën e tij. Pushtuesit fashistë italianë botonin më se 40 organe shtypi, përveç mjeteve të tjera të agjitacionit e të propagandës siç ishin radio, film, aktivitete artistiko-kulturore, organizata fashiste etj. Kur propaganda e tij u demaskua e populli i ktheu krahët, ai filloi të propagandojë "kotësinë" e luftës e dëmet e saj, sepse Italia fashiste do të merrte masa të rënda shtypëse e Shqipëria do të shkatërrohej. Kur lufta e armatosur e popullit shqiptar mori zhvillimin e saj të plotë dhe pushtuesi fashist po pësonte goditje të rënda, propaganda e tij lëshoi parrullat e "rrezikut bolshevik" e atij "serb e grek" etj., duke u përpjekur të krijonte dyshime mbi LANÇ e objektivat e saj. Pushtuesi nazist gjerman po ashtu nuk mbeti prapa nga pushtuesi i mëparshëm në përdorimin e mjeteve të propagandës.

Komanda e forcave ushtarake gjermane në organin e saj "Liria e Shqipërisë" të botuar prej 10.000 kopje në ditë theksonte se "Gjermania naziste s'kishte ardhur për të pushtuar vendin por për ta mbrojtur", se "Shqipëria, -sipas tyre, -ishte çliruar". Kjo tezë u bë copë e thërrime nëpërmjet propagandës së LANÇ-it dhe luftës së armatosur kundër tyre.

Shtypi partizan vlerësohej dhe ngrinte lart patriotizmin, besnikërinë, vendosmërinë, dashurinë për njeri-tjetrin, ndershmerinë etj. Shtypi i armikut popularizonte terrorin, masakrat dhe kërcënonte me masa të tjera shtypëse, kurse në faqet e shtypit partizan ngruhej lart lufta e popullit, aksionet e tij të guximshme, heroizmi e sakrificat në luftë për çlirim e Atdheut. Kështu shpiti partizan gjatë LANÇ-it ka luajtur një rol parësor në edukimin, mobilizimin dhe në përshkrimin e rënies heroike të dëshmorëve partizanë. Ai u bë një forcë morale edhe për popullin e thjeshtë i cili, u vendos në kushte të vështira gjatë kësaj lufte, por që ruajti dhe mbrojtji vlerat dhe traditat më të mira të trashëguara në shekuj. Kudo shtypi partizan mirëpritej dhe lexohej nga populli i thjeshtë.



Menaxhim dhe shuarja e zjarreve: Forca Tokësore dekorohet me "Medalje e Artë për Vlerësim Profesional" dhe me "Medalje e Mirënjohjes"

Më 3 shtator 2021 në Bazën Ajrore të Farkës u zhvillua ceremonia e vlerësimit të strukturave dhe individëve që u angazhuan në operacionet për shuarjen e zjarreve në vend. Pjesë e kësaj ceremonie ishte kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, ambasadori i Bashkimit Evropian Luigi Soreca, zëvendësambasadori i SHBA, zyrtarë të lartë të ftuar në vend. Kjo ceremoni u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha strukturave që kontribuan për shuarjen e zjarreve në vend, Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile etj. Forca Tokësore u dekorua me "Medaljen e Artë për Vlerësim Profesional" nga kryeministri i Republikës së Shqipërisë, si dhe me "Medaljen e Mirënjohjes" nga ministri i Mbrojtjes, për kontributin e dhënë në shuarjen e zjarreve.

